



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News:

Raporti i ngjarjeve, 3,4,5 shkurt 2024

Romë, Itali – Në ambientet e Departamentit për Sigurinë Publike të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Italisë, u zhvillua takimi i parë trepalësh, mes përfaqësuesve më të lartë të strukturave policore italiane, shqiptare dhe të atyre të Mbretërisë së Bashkuar

DVP Fier/Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 5 të tjerë, për vepra penale të ndryshme

Bogë – Policia ndihmon një grup alpinistësh të cilët kishin mbetur të bllokuar në një terren malor

DVP Elbasan – Vihen në pranga 3 shtetas, për vepra të ndryshme penale



Lajmet

05/02/2024

DVP Fier/Vihet Në Pranga 1 Shtetas Dhe Procedohen Në Gjendje Të Lirë 5 Të Tjerë, Për Vepra Penale Të Ndryshme

DVP Fier/ Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 5 të tjerë, për vepra penale të ndryshme.

Si rezultat i kontrolleve të mbështetura te inteligenca policore dhe të kryera në kuadër të planit operacional të koduar “Sundimi i ligjit”, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Lushnjë zbuluan një tjetër lokal ku viheshin baste sportive, me celularë. Në lokalin në pronësi të shtetasit V. S., 29 vjeç, në lagjen “Çlirimi”, u panë shtetasit S. H., 30 vjeç dhe A. B., 61 vjeç, teksa vinin baste sportive, me celularë. Në përfundim të veprimeve procedurale për rastin, nisi procedimi në gjendje të lirë për të 3 këta shtetas, si dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, 2 celularë.

Specialistët e Sektorit për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Fier arrestuan në flagrancë shtetasin J. H., 26 vjeç, banues në Fier, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj nënës së tij dhe se ka tentuar të kryejë marrëdhënie seksuale, me dhunë, me motrën e tij 16 vjeçe.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Lushnjë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin I. S., 28 vjeç, banues në Divjakë, pasi nuk i është bindur urdhrit të punonjësve të Policisë, për të kryer kontrolle në automjetin e tij, ku u gjetën 13 fishekë arme gjahu.

Specialistët e Sektorit të Policisë Rrugore të DVP Fier referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin M. H., 22 vjeç, banues në Lushnjë, pasi u kap duke drejtuar automjetin, pa leje drejtimi.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Bogë – Policia ndihmon një grup alpinistësh të cilët kishin mbetur të bllokuar në një terren malor

Romë, Itali – Në ambientet e Departamentit për Sigurinë Publike të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Italisë, u zhvillua takimi i parë trepalësh, mes përfaqësuesve më të lartë të strukturave policore italiane, shqiptare dhe të atyre të Mbretërisë së Bashkuar ▶